



Prishtinë, 30 qershor 2014

Kodi i ZRRE: V_639_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së); dhe
- Aplikacionin e KEDS-OSSH-së të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE8) me dokumentacionin relevant sqarues.
- Vendimin nr. V_634_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OSSH;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e datës 26 qershor 2014 të KEDS –it dorëzuar ZRRE për miratimin e ngarkesave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 30 qershor 2014 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin relevant tarifor apo SHTE8, i cili fillon nga 1 prilli 2014.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), më datën 26 qershor kërkesën për shqyrtim të ngarkesës së rregulluar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (DUOS);
- Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës shkurt-maj 2014. Këto dokumente janë:
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;



- Raporti Përfundimtar - Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 24 qershor 2014; dhe
 - Përgjigjet ndaj Komenteve të KEDS-it - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.
- II. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Struktura e ngarkesave për OSSH, që do të zbatohet nga data 1 prill 2014, përkatësisht në vitin relevant tarifar SHTE8 është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Ngarkesat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.12
10 kV	€/kWh	1.28
0.4 kV	€/kWh	2.07

- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar